



Pranuar / Dorezuar Priljezo/Prodato Received/Delivery	19-07-2023	3 viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	SKPM/SHIK	5309/2023
Nr Prot Br Prot Prot No		114
Shënimi Prilog Appendix		
Sasia Kolicina Quantity		



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosova

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHERBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADBORNI ODBOR CIVILNE SLUZBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.813/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.813/2023 të datës 05.06.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

**I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.813/2023 e datës 05.06.2023, e parashtruar nga ankuesi ashtu që aprovohet pretendimi ankimor për pagesë retroaktive të diferencës së pagës, ndërsa refuzohet pretendimi për njohje të koeficientit të pagës 6.54.

**II. Obligohet** Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësja e Personelit të Komunës së Lipjanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet nevojshme ligjore për kompensimin e diferencës së pagës për ankuesin, nga koeficienti 4.95 në koeficientin 6.54, të gjitha këto për periudhën shkurt, mars, prill dhe maj 2023.

**III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje ankuesi) i punësuar në Komunën e Lipjanit, më datë 05.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.813/2023, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe aplikimi të gabuar të dispozitave materiale, me pretendimin ankimor se Komuna e Lipjanit gabimisht e ka kategorizuar ankuesin në klasën profesionale 3 me koeficient 3.96 të pagës, sepse ankuesi si gjeometër kategorizohet si specialist sipas Shtojcës 10.7 koeficient 6.54.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa, Këshilli me datë 13.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4587/2023 të datës 05.06.2023 të parashtruar nga ankuesi përmes avokatit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Autorizimin e datës 05.04.2023 për përfaqësim të ankuesit; Kërkesën nr. 1-120/02-18084 e datës 12.04.2023 nga ankuesi për Zyrën e Personelit të Komunës së Lipjanit; Listën e pagave shkurt 2023t; Kërkesën nr. 1-120/04-25064 të datës 16.05.2023 nga ankuesi për Zyrën e Personelit të Komunës së Lipjanit; Përgjigjen e datës 18.05.2023 nga Udhëheqësja e Sektorit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit për ankuesin lidhur me kërkesën e datës 16.05.2023; E-maili i datës 11.01.2023 nga Menaxherja e Personelit për regjistrin e klasifikimit të vendeve të punës për Komunën e Lipjanit; Propozim nga Komuna; Vendimi me Nr.04/128 i datës 16.02.2023 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesën për korrigjime të koeficienteve në listë të pagave me nr.01-120/02-11652 të datës 06.03.2023 nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Lipjanit për DMZP; Lista e korrigjimit të koeficienteve për zyrtarët e Administratës Komunale të Lipjanit e datës 03.03.2023 e nënshkruar nga Kryetari i Komunës të Lipjanit; E-maili i datës 18.04.2023 nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për Menaxheren e Personelit në Komunën e Lipjanit; Informatë për Zyrtarin Publik në Komunën e Lipjanit data e shqyrtimit 27.04.2023; Formulari i të dhënave për listën e pagave e datës 02.05.2023; Formulari i të dhënave i datës 04.05.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023 nga Këshilli për Menaxheren e Personelit; Përgjigjen në ankesë e datës 13.07.2023 nga organi i punësimit për Këshillin bashkë me shkresat e lëndës; E-maili i datës 04.07.2023 nga zyrtari i personelit për Këshillin; Akt emërimi i datës 05.12.2011; Lista e pagave për muajin qershor 2023; Lista e pagave për muajin maj 2023; Kërkesa me nr.01-120/02-11625 e datës 06.03.2023 nga Udhëheqësja e Personelit për DMZP; E-maili i datës 18.04.2023 nga DMZP për Udhëheqësen e Personelit dhe Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Gjeometër i datës 09.10.2012.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit dhe së i njëjti sipas Akt emërimit të datës 05.12.2011 është emëruar dhe njëjti ushtron pozitën e punës Gjeometer me koeficient gjashtë (6) të pagës.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesi fillimisht ishte përfshirë në listën e pagës, në klasën profesionale 3, GJ44 me koeficient 3.94. I pakënaqur me këtë sistemim, ankuesi më datë 12.04.2023 dhe 16.05.2023 parashtron kërkesë pranë organit të punësimit për përfshirje në pozitën Specialist me koeficient 6.54 si dhe pagesën në mënyrë retroaktive e diferencës në pagë sipas koeficientit 6.54 duke filluar nga muaji shkurt.

Tutje nga provat e parashtruara nga organi i punësimit rezultoi se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka bërë korrigjimin e kategorizimit të pagës së ankuesit, ashtu që ankuesi në listën e pagave për muajin maj 2023 është kategorizuar në klasën profesionale 2, GJ36- me koeficient 4.95, me ç' rast ankuesit edhe i është paguar diferenca e pagës nga koeficienti 3.94 në koeficientin 4.95.

Ankuesi me datë 05.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për sistemimin e ankuesit në listën e pagave sipas Ligjit Nr.08/L-196 për



Pagat në Sektorin Publik lidhur me shtojcën 10.7 në pozitën Specialist me koeficient 6.54, si dhe për kompensim në mënyrë retroaktive sipas koeficientit 6.54.

Bazuar në nenin 2 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. Në këtë kontekst, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku theksohet se: *përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë se i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik* andaj, sipas këtij përcaktimi ligjor rrjedhë se çdo nëpunës civil i cili pretendon se i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil nga veprimi administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) i organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtroj ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të shqyrtimin e besueshmërisë së pretendimeve ankimore kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht:

- **Nenit 1:** *Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.*

- **Nenit 3:** ... **1.6. klasa e pagës** - nënkupton nivelin e pozicionimit në hierarkinë e përgjithshme të funksioneve në shkallën e pagës e që i korrespondon koeficienti i caktuar dhe që përbëhet nga një grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë kompleksiteti dhe që përfitojnë të njëjtën pagë bazë; **1.7. koeficienti i pagës apo koeficienti** – nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion;... **1.9 paga bazë** – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji;

- **Nenit 4 Parimet e sistemit të pagave** **1.Sistemi i pagave i rregulluar me këtë ligj bazohet në parimet e mëposhtme:** **1.1. parimi i ligjshmërisë** - nënkupton se e drejta në pagë përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore të autorizuar dhe të nxjerra në zbatim të tij; **1.2. parimi i transparencës** – nënkupton që përcaktimi i pagës dhe të drejtave të tjera që burojnë nga paga, është informacion me interes publik dhe trajtohet në pajtim me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale; **1.3. parimi i parashikueshmërisë** – nënkupton se niveli i pagës, i përcaktuar sipas këtij ligji, mund të ulet, vetëm në bazë të ligjit; **1.4. parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit** – nënkupton që secili, pa kurrëfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimin.

- **Neni 6 Paga bazë** **1. Paga bazë është pjesa fikse e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji.**



Rrjedhimisht nisur nga kuadri ligjor si me sipër, e duke marr për bazë pretendimin ankimor të ankuesit për njohje të së drejtës së pagës sipas koeficientit 6.52, shtojca Nr.10.7 e Ligjit Nr.08/196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës nga dhe ka konstatuar së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në zbatim të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka bërë korigjimin e koeficientit të ankuesit në muajin qershor 2023, duke e sistemuar të njëjtin në listën e pagave me emërtim të pozitës *Specialist, klasa GJ12, koeficient 6.54*, duke vepruar kështu në pajtim me shtojcën Nr.10.7 pika 12 të Ligjit Nr.08/196 për Pagat në Sektorin Publik, andaj, duke qenë së ankuesit i janë bërë përmirësimet e koeficientit të pagës sipas nivelit/gradës së kërkuar si në ankesë, Kolegji konstaton së pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk qëndron dhe se objekti i këtij pretendimi ankimor tani me, është bërë i pamundur apo i kotë.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor për kompensim retroaktiv të diferencës së koeficientit, Kolegji nga shqyrtimi i provave material ka gjetur se ankuesit në muajin maj i është realizuar diferenca e pagës nga profesional 3 GJ44, koeficienti 3.94, në profesional 2 GJ 36 koeficient 4.95 4 për periudhën shkurt, mars, prill dhe maj 2023, atëherë mbi këtë fakt dhe duke marrë parasysh se Ligji Nr.08/196 për Pagat në Sektorin Publik ka hyrë në fuqi me datë 05.02.2023, Kolegji konstaton së ky ligj krijon pasoja juridikë nga data e hyrjes në fuqi, andaj ashtu siç është përcaktuar edhe me vet Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Kosovës pika 4, ankuesit i lind e drejta e kompensimit retroaktiv të diferencës së papaguar të pagës nga koeficient 4.95 në koeficientin 6.54, kështu që obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësja e Personelit të Komunës së Lipjanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet nevojshme ligjore për kompensimin e diferencës së pagës për ankuesin, nga koeficienti 4.95 në koeficientin 6.54, të gjitha këto për periudhën shkurt, mars, prill dhe maj 2023.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.813/2023**

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit me Autorizim Avokati
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së